

Udhëzues për kujdestarë

Me marrjen e kujdestarisë ju përmbushni një detyrim qytetar të rëndësishëm. Ju merrni përsipër një detyrë vullnetare, të cilën ju do ta drejtoni me ndërgjegjësimit, vetëpërgjegjësi dhe pa përjashtim në interes të personit, që është nën kujdestarinë ligjore.

Dispozitat ligjore në lidhje me kujdestarinë janë të përfshira në Kodin Civil (nenet 1773 deri 1808) E drejta dhe detyrimi ligjor për t'u kujdesur për personin nën kujdestarinë ligjore, përcaktohen në bazë të neneve 1631a deri 1632 të Kodit Civil (neni 1795 i Kodit Civil). Është e këshillueshme, të informohet rreth këtyre dispozitave.

Në mënyrë të veçantë do të udhëzohet si vijon më poshtë:

a) Ju keni të drejtën dhe përgjegjësinë të kujdeseni e të përfaqësoni personin nën kujdestarinë ligjore si dhe pasurinë e tij. Ju nuk lejoheni ta përfaqësoni atë ndër të tjera tek veprimet juridike ose proceset, ku jeni të përfshirë dhe ju personalisht – nën emrin tuaj ose si përfaqësues i një pale të tretë – në proceset me bashkëshortin tuaj, me partnerin tuaj, ose me një të afërm familjar si dhe në çështjet, për të cilat është e nevojshme kujdestaria.

- I. **Kujdestaria ligjore për personin** përmbledh të drejtën ligjore dhe detyrimin për të edukuar, për të mbikqyrur si dhe për të përcaktuar qëndrimin e personit, i cili është nën kujdesjen ligjore. Këtu bën pjesë gjithashtu dhe bisedimi apo sqarimi me personin, që është nën kujdestarinë ligjore mbi masat, që do të ndërmerren për atë sa e dëshmon gjendja aktuale e zhvillimit të tij. Për strehimin e personit nën kujdestarinë ligjore, i cili është i lidhur me heqjen e lirisë me ose kundra vullnetit të tij, ju keni nevojë për miratimin e Gjykatës për Çështjet Familjare.
- II **Kujdestaria për pasurinë** e personit, që është nën kujdestarinë ligjore ju vë para përgjegjësisë të administrimit dhe të merrni këtë pasuri sipas rregullave dhe të ushtroni të drejtat përkatëse të shpenzimeve.

Me marrjen e funksionit të detyrës suaj, dorëzoni tek Gjykata për Çështjet Familjare një listë të pasurisë së personit, i cili është nën kujdestarinë ligjore, sipas shembullit të caktuar si dhe garantoni saktësinë e korrektësinë e saj. Në rast se personit, që është nën kujdestarinë ligjore, i vjen më vonë një pasuri e caktuar, atëherë luteni të plotësoni listën.

Ju nuk lejoheni të përdorni pasurinë e personit, që është nën kujdestarinë ligjore për nevojat tuaja personale. Gjithashtu ju nuk lejoheni të bëni dhurime nga pasuria e personit nën kujdestarinë ligjore, vetëm në rastin kur bëhet fjalë për një detyrim moral ose kur e kërkojnë rregullat e mirësjelljes.

Paratë e të mbrojturit, që kërkohen për shpenzimet e tij (paratë në dispozicion) duhet të bëhen gati në një llogari të mbrojturit tek një institucion krediti. Paratë e të mbrojturit, të cilat nuk duhen si para në dispozicion, duhet të investohen (para investimi), në një llogari të mbrojturit së përshtatshme për investimet me cinza tek një institucion krediti (llogari investimi). Institucioni përkatës i kredisë duhet t'i përkasë një institucioni të sigurisë që është i mjaftueshëm për investimin përkatës. Miratimi i gjykatës familjare kërkohet për një formë tjetër të investimeve. Do jepni përgjegjësi ndaj gjykatës familjare për administrimin e pasurisë të mbrojturit pa kërkesë të veçantë, përveç nëse specifikohet ndryshe, gjdo vitë jo më vonë se një muaj pas përfundimit të vitit kontabël. Fatura duhet të përmbajë një përmbledhje të rregullt të të ardhurave dhe shpenzimeve; Faturat për artikujt individualë duhet të bashkëngjiten.

Ju duhet t'i raportoni Gjykatës për Çështjet Familjare të paktën një herë në vit informacione për marrëdhëniet personale të personit, që është nën kujdestarinë ligjore.

- b) Në lidhje me një sërë veprimesh juridike, të cilat ju do t'i ndërmerrni për personin, që është nën kujdestarinë ligjore, juve ju nevojitet miratimi i Gjykatës për Çështjet Familjare, mbi të gjitha
1. për disponimin e kërkesës së personit, që është nën kujdestarinë ligjore,
 2. për veprimet juridike lidhur me një truall ose të drejtën e një trualli, psh. për blerjen apo shitjen e një trualli dhe debitimin e truallit me hipotekat ose të drejtat e tjera,
 3. për disponimin lidhur me të gjithë pasurinë, apo me një trashëgimi, ose lidhur me pjesën e trashëgimisë ligjore në të ardhmen,
 4. për zgjidhjen e një trashëgimie ose një prokure si dhe për kontratën e ndarjes në pjesë të trashëgimisë,
 5. për përvetësimin, për shitjen/kalimin, përpilimin ose zgjidhjen e një aktiviteti fitimprurës
 6. për një kontratë qiraje, ose kontratë tjetër, me anë të së cilës personi, që është nën kujdestarinë ligjore, detyrohet për detyrime të vazhdueshme, në rastin kur raporti i kontratës duhet të zgjasë më shumë se 1 vit, pasi personi nën kujdestari ka hyrë në moshë madhore,
 7. për një kontratë shkollimi profesional, përfundimi i së cilës nuk është i mundur brenda vitit,
 8. për marrjen e një borxhi për personin, që është nën kujdestari,
 9. për marrjen e një nënshtetësie,
 10. për një kompromis ose kontratë pajtimi, nëse vlera e objektit të mosmarrëveshjes e kalon shumë prej 6.000,00 Euro. (Kjo nuk vlen në rastin kur kompromisi përkon me një propozim pajtues me shkrim dhe të protokolluar nga ana gjyqësore)

Kjo listë nuk është e plotë. Në rast dyshimi ju lutem informohuni tek Gjykata për Çështjet Familjare. Një kontratë, e cila është lidhur para miratimit të nevojshëm, është e pavlefshme. Ju duhet të merrni më vonë miratimin nga Gjykata për Çështjet Familjare dhe këtë t'ia transmetoni palës kundërshtuese. Nuk mjafton fakti, nëse pala kundërshtuese informohet nga një palë e tretë. Ju duhet të vendosni vetë, nëse ju do të lejoni vlefshmërinë e kontratës nëpërmjet njoftimit të miratimit. Një veprim juridik **i njëanshëm**, i cili ka nevojë për miratim, është i vlefshëm **vetëm pas** marrjes së miratimit.

- c) Ju lutem informoni menjëherë çdo ndryshim të adresës suaj apo të personit, që është nën kujdestari pranë Gjykatës për Çështjet Familjare dhe Zyrës për Çështjet e Minorenëve.
- d) Gjykata për Çështjet Familjare mbikqyr tërësinë e veprimtarisë suaj, dhe lidhur me këtë përkrahet nga Zyra për Çështjet e Minorenëve. Ajo mund të kërkojë nga ju në çdo kohë informacione mbi drejtimin e funksionit tuaj dhe marrëdhëniet me personin, që është nën kujdestarinë ligjore. Zyra për Çështjet e Minorenëve dhe – në rast se është e demostdoshme – Gjykata për Çështjet Familjare ju këshillon për të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me funksionin tuaj.

Në rastin kur kujdestari cënon detyrimet e tij me vetëdije, atëherë ai është përgjegjës për dëmet e shkaktuara para personit, që është nën kujdestarinë ligjore. Ju mund të siguroheni kundër këtij rreziku. Për më tej mund të informoheni pranë Gjykatës për Çështjet Familjare.

- e) Funkzioni juaj përfundon, kur personi, që është nën kujdestarinë ligjore hyn në moshën madhore, ose nëse ju liroheni nga funksioni juaj. Ju mund të shkarkoheni, me kërkesën për shkak arsyesh të rëndësishme, ose nëse vazhdimi i funksionit tuaj do të rrezikonte interesin e personit që është nën kujdestarinë ligjore.